



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 04 nëntor 2016, në orën 09:30
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Bali Muharremaj, Synavere Rysha, Enver Hoti, Naim Fetahu dhe Fikrim Damka.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Valon Murati, Flaka Braha, Abdyl Lipoveci, Ragip Zejnullahu, nga Ministria e Diasporës; Emine Fazliu dhe Zuk Zuka, ZKA.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 12.10.2016 dhe 19.10.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Diasporës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar ministri, z. Valon Murati;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar ministri z. Memli Krasniqi;
5. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 12.10.2016 dhe 19.10.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12.10.2016 dhe 19.10.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Diasporës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari, theksoi se KMFP ka vendosur ta shqyrtojë Raportin e auditimit për Ministrinë e Diasporës (MD), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Opinionin i auditimit, për këtë raport, është i pamodifikuar, me theksim të çështjes, pra theksimi i çështjes është dhënë për shkak se Ministria e Diasporës ka mbivlerësuar pasurinë për 50,000 euro. Me këtë, hapi diskutimin duke ia dhënë fjalën ministrit të Ministrisë së Diasporës.

Valon Murati, ministër i Ministrisë së Diasporës, paraqiti në pika të shkurtra angazhimin e Ministrisë, në kontest të adresimit të rekomandimeve të dala nga Raporti i auditimit të Ministrisë së Diasporës, për vitin 2015. Përmendi defektet që ishin në regjistrim të pasurisë në sistemin e E-pasurisë, mbivlerësimin e depos në shumën prej afër 50,000 euro. Pagesa e tre drejtorëve që janë jashtë vendit, e që nuk mund të futën në listën e pagave, për shkak numrit të kufizuar të punëtorëve etj. Arsyetimet në detaje, janë në incizim të kësaj mbledhjeje.

Emine Fazliu, auditore në ZKA, thekoi se të gjitha të gjeturat janë të paraqitura në raport. Pra, opinionin është i pamodifikuar, me theksim të çështjes dhe mendoj se raporti është i qartë dhe nuk kam diçka më tepër për të theksuar.

Ali Sadriu, theksoi se opinionin i auditimit për PVF-të e Ministrisë së Diasporës, për vitin 2015, është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka të bëjë me vlerën e pasurive nën 1,000€, si dhe të stoqeve në depo, respektivisht me pamundësinë e marrjes së sigurisë së mjaftueshme, në lidhje me vlerën e saktë të pasurive të shpalosura në PVF-të. Raporti i auditimit për PVF-të, të vitit 2014 të Ministrisë së Diasporës, ka rezultuar me 9 rekomandime kryesore. Ministria e Diasporës kishte përgatitur një plan veprimi, ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet. Deri në kohën sa ZKA ishte në auditim, 4 rekomandime ishin implementuar, 4 ishin në proces ndërsa 1 nuk ishte implementuar. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit. Si pjesë e auditimit, ZKA ka shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit, në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara, ka gjetur procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur nga Ministria e Diasporës; moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut, Ministria e Diasporës ende nuk kishte të hartuar një regjistër, ku do të identifikoheshin dhe vlerësoheshin qartë të gjitha rreziqet e mundshme në drejtim të arritjes së objektivave të Ministrisë së Diasporës; pyetësori i vetëvlerësimit, i plotësuar nga Ministria e Diasporës, ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Dobësi në kontrollet menaxheriale, Ministria e Diasporës kishte vendosur një sistem të raportimit, ku menaxherët e njësive dërgonin raporte mujore tek ZKA. Megjithatë, cilësia e raporteve nuk ishte në nivel të kënaqshëm, pasi që

menaxherët e departamenteve dorëzonin vetëm raporte narrative dhe nuk raportnin sa i përket realizimit të objektivave dhe analizimit të buxhetit për njësinë që menaxhohin. Dobësi sistematike në menaxhimin e shpenzimeve, LMFPP, si dhe rregulla financiare 01/2013, përcakton hapat që duhet ndjekur se si mund të procesohen pagesat nga buxheti. Ministria e Diasporës kishte lidhur marrëveshje bashkëfinancimi me UNDP-në, duke anashkaluar procedurat e prokurimit për projektin: “Fushata për promovimin e regjistrimit të diasporës”. Obligimet e Ministrisë së Diasporës ishin 60,000€, ku sipas marrëveshjes kjo shumë do të paguhej si avancë, ndërsa pagesa e kryer si e tillë, nuk ishte në pajtueshmëri me LMFPP. Ministria e Diasporës, në fund të muajit gusht, kishte ndërprerë kontratën: “Shërbimet e udhëtimit me aeroplan”. Gjatë periudhës shtator-dhjetor, Ministria e Diasporës kishte pranuar oferta për secilin avion, biletë të kërkuar, por që këto procedura nuk kishin kaluar përmes zyrës së prokurimit, siç kërkohet në LPP. Shuma e shpenzuar për këto shërbime, për këtë periudhë, ishte 26,263. Mangësi në menaxhimin e subvencioneve, dhënia e subvencioneve është rregulluar me Rregulloren 01/2014, ku përcaktohen kriteret dhe mënyra e subvencionimit të projekteve për diasporën dhe mërgatën, përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë gjatë subvencionimit. Sipas rregullores për subvencionimin e OJQ-ve, grupeve të interesit, si dhe për individët, kërkohet që dosja e aplikimit të posedojë statutin e OJQ-së dhe CV-në e bartësit të projektit. Ne kemi konstatuar se tre përfitues të subvencioneve, nuk i kishin bashkëngjitur/dorëzuar statutin e OJQ- së, ndërsa 13 aplikacioneve iu mungonin CV-të në dosjen e aplikimit për subvencionim. Gjatë kësaj periudhe, raportimi i përfituesve të subvencioneve ishte dukshëm më i mirë se në vitin e kaluar. Mirëpo, gjatë testimit të mostrave, konstatuam se dy përfitues kishin dorëzuar raportet e realizimit me vonesë, deri në një muaj, pas afatit të përcaktuar ligjor, përderisa katër përfitues nuk kishin dorëzuar raporte as pas përfundimit të vitit.

Enver Hoti, pyeti se a ekzistojnë kontrole të brendshme, në kuadër të Ministrisë së Diasporës, dhe nëse po, pse janë lejuar të ndodhin këto shkelje të dhëna në raport? Po ashtu, marrëveshja për pagesën e drejtorëve jashtë vendit, pse është lejuar pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si të punësuar në kontratë në vepër?

Synavere Rysha, theksoi se mosadresimi i rekomandimeve, le të kuptohet se në Ministrinë e Diasporës nuk ka progres. Po ashtu, në raport thuhet se janë konstatuar disa shkelje, si në regjistrim të pasurisë, mbivlerësim të stoqeve, pagesa e drejtorëve në diasporë nga kategoria mallrave dhe shërbimeve etj. Pse nuk është bërë pranimi i tyre përmes proceduarve të konkursit?

Naim Fetahu, theksoi se Ministria e Diasporës ka bërë një punë të mirë gjatë vitit 2015. Megjithatë, bazuar në rekomandimet e dala nga ky raport, kërkohet angazhim shtesë i ministrit të Diasporës për implementim të këtyre rekomandimeve.

Abdyl Ymeri, falënderoi auditorët për punën e bërë në këtë raport. Përmendi në pika të shkurtra sfidat e Ministrisë së Diasporës gjatë vitit 2015, në kontest të adresimit të rekomandimeve nga

viti paraprak. Mendoj se të gjeturat janë minimale. Marrëveshja me UNDP-në, si bashkë-financues i projekteve të ndryshme, pret një sqarim për këtë, se ku qëndron problemi i shkeljeve të konstatuara këtu, tek Ministria e Diasporës apo tek UNDP?

Hajdar Beqa, theksoi se Raporti i auditimit për Ministrinë e Diasporës, për vitin 2015, me opinion të pamodifikuar, me theksim të çështjes, le të kuptohet se ne si KMFP, vetëm mund t'i rekomandojmë Ministrisë së Diasporës, që të rritet kontrolli në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Po ashtu, do t'i kisha rekomanduar ministrit të Ministrisë së Diasporës, se nëse ka pengesa në numër të stafit për të punësuarit në Ministrinë e Diasporës, që të jenë punëtorë të rregullt, atëherë këtë mund ta adresojë në KBF dhe do ta ketë mbështetjen e deputetëve të KMFP-së, që janë pjesë e KBF-së.

Valon Murati, u përgjigj në të gjitha pyetjet e deputetëve, për sa i përket angazhimit të Ministrisë së Diasporës, në adresimin e të gjitha rekomandimeve. Më konkretisht, ekziston incizimi i diskutimit.

Faton Topalli, theksoi se Ministria e Diasporës, duhet të marrë veprim konkret për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit, si dhe mos të lejojë përsëritjen e lëshimeve të ngjashme nga viti paraprak.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, vendosi që Raportin e auditimit për PVF- të e Ministrisë së Diasporës, të mos e adresojë për seancë plenare, duke i rekomanduar Ministrisë së Diasporës, që t'i zbatojë në përpikëri rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe me një raport ta njoftojë KMFP-në, deri në fund të muajit janar 2017.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, theksoi se ministri i MBPZHR-së, për shkak se është në vizitë jashtë vendit, nuk do të marrë pjesë në këtë mbledhje të KMFP-së dhe propozoi që kjo pikë e rendit të ditës, të shtyhet për takimin e radhës të KMFP-së.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, vendosi që Raportin e auditimit për PVF- të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, ta shqyrtojë në mbledhjen e radhës të Komisionit.

5. Të Ndryshme

Faton Topalli , theksoi se pasi nuk pati diskutime në këtë pikë, e mbylli takimin.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli